

LSI: Nr. 447 Prot
Datë: 09.05.2021

KËRKESË ANKIMORE

MODEL - KA

Drejtuar: Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS)
në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Adresa: Rruga " Ibrahim Rugova", Ndërtesa nr.4: Tiranë

ANKUESI

Subjekti Ankues	Adresa, posta elektronike dhe/ose nr. i telefonit Rr. Sami Frasheri, Godina 20/10, Tirane Tel: +355 4 4504187 Email: info@lsi.al
-----------------	---

LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM (LSI)

OBJEKTI I ANKIMIT

Ndryshimi i Vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve Nr. 339, Datë 4.5.2021

TITULLI I VENDIMIT

Vendimi

"Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatit e votimit në zonën zgjedhore Qarku Berat, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021".

Nr.

Datë

7

9/05/2021

- Ndryshimi i Vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve Nr. 339, datë 4.05.2021 Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatit e votimit në zonën zgjedhore Qarku Berat, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021
- Rinumërim dhe rivlerësim i votave për ZAZ-të 63, 64, 65, 66, 67, 68 dhe QV-të e listuara në tabelën e mëposhtme dhe miratim i tabelës përmbledhëse për zonën zgjedhore Qarku Berat duke përfshirë në të rezultatit e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave për QV-të e listuara në tabelë.

Baza Ligjore:

Nenet: 3, 8, 21, pika 1, gërma "a", neni 26 pika 2, nenet 115, 116, 117, 118, 119, 122, 123/3, 124, 126, 133, 136, 138, 141, 143, 160 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar



[Signature]
Ndryshimi i Ankuesit

PËRSHKRIMI I SHKELJES SË PRETENDUAR

Lëvizja Socialiste për Integrim, me vendimin nr. 70, datë 15.2.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është regjistruar si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021. Në vijim, me vendimin nr. 147, datë 16 Mars 2021 janë miratuar Listat shumemërore të partisë Lëvizja Socialiste për Integrim për zgjedhjet për kuvendin të datës 25 prill 2021.

Në datën 25.04.2021, në 12 Zonat Zgjedhore në Republikën e Shqipërisë u zhvilluan zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë. Zona Zgjedhore Qarku Berat ka 6 (gjashtë) zona të administrimit zgjedhor, përkatësisht ZAZ nr 63, ZAZ nr. 64, ZAZ nr. 65, ZAZ nr. 66, ZAZ nr. 67 dhe ZAZ nr. 68.

Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave KZAZ-të përkatëse plotësuan e miratuan tabelat përmbledhëse të rezultateve për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë të zonave përkatëse.

KZAZ nr. 63, KZAZ nr. 64 KZAZ nr. 65, KZAZ nr. 66, KZAZ nr. 67, KZAZ nr. 68, kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Tabelat Përmbledhëse të Rezultateve për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për Kuvend për çdo subjekt zgjedhor për zonën e administrimit zgjedhor përkatës, vendimin "Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për subjektet zgjedhore" dhe vendimet "Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për kandidatët për deputet", tabelat origjinale të rezultatit për çdo qendër votimi dhe tabelat origjinale të rezultateve për kandidatët për deputet për çdo subjekt zgjedhor, për çdo qendër votimi të ZAZ-ve të sipërcituara.

Në bazë të rezultateve përmbledhëse të zonave të sipërcituara, rezultateve për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet për çdo subjekt zgjedhor janë hartuar tabelat përmbledhëse të rezultateve për zonën zgjedhore Qarku Berat.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në seancën publike të datës 4 maj 2021, me Vendimin Nr. 339, ka vendosur:

1. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për subjektet zgjedhore, për zonën zgjedhore Qarku Berat, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për kandidatët për deputetë për zonën zgjedhore, Qarku Berat në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga shpallja e tij.

Lëvizja Socialiste për Integrim, ka ardhur në dijeni të fakteve, indicieve dhe ka siguruar prova të mjaftueshme lidhur me problematika dhe parregullsi të procesit zgjedhor të ndodhura në Zona të Administrimit Zgjedhor dhe Qendra të Votimit të Qarkut Berat.

1. Nga informacioni i vënë në dispozicion nga KQZ, rezulton se në disa QV u gjenden në kutin e fletëve të votimit, fletë votimi pa vula, fakt i cili përveç se bie në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe Akteve Normative të miratuara nga Komisioni Rregullator, përbën indicie dhe provë të qartë dhe na bën të besojmë se janë futur fletë votimi nga jashtë QV-ve, të cilat kanë qarkulluar dhe janë plotësuar nga subjekti politik si garanci që votuesit e intimiduar, ndikuar apo blerë të mos i mashtronin.
2. Në çdo ZAZ janë konstatuar tentativa për votim të dyfishtë nga i njëjti zgjedhës, fakt i konstatuar nga printimet e PEI.
3. Është konstatuar mungesë e operatorit PEI në **QV 3446 Karkanjoz**. Në këtë QV, procesi i identifikimit u krye nëpërmjet listës zgjedhore manuale, pasi u informua KZAZ. Për këtë procedurë



[Signature]
Përkrahësi i Ankuesit

nuk disponohet asnjë vendim apo procesverbal i KQV-së, nuk është mbajtur nga kjo e fundit në librin e protokollit ky fakt, dhe nga KZAZ-ja përkatëse nuk është shënuar ky fakt në librin e vetë të protokollit (nuk disponohet vendim).

4. Nga verifikimet në **QV. 3431 Ullinjas**, pas hapjes së kutisë së fletëve të votimit dhe verifikimit të procesverbalit të mbylljes me printimin PEI, u konstatuan mospërputhje të tyre në numër zgjedhësish, fletë votimi, dhe gjinisë femërore. Për këtë arsye u krye hapja e kutisë së materialeve zgjedhore dhe u kostatua se edhe aty kishte mospërputhje ndërmjet raportit PEI dhe procesverbalit. Nga raporti i PEI rezultoi se u identifikuan 206 femra ndërkohë që në procesverbal është shënuar shifra 211 femra. Në raportin PEI rezultoi se nuk u njohën shenjat e gishtave në 39 raste, ndërsa në procesverbal citohej 13 raste. Në raportin PEI, rezultoi se ishte një rast i veçantë me vendim gjykate, ndërkohë që ky rast nuk ishte i evidentuar në librin e protokollit, si dhe nuk kishte të administruar vendimin e gjykatës në formën e kërkuar nga ligji. Një rast votimi ishte i shtuar në regjistrin e posaçëm, por pa u cituar arsyeja. Në regjistrin e votuesve u vunë re shtesa të emrave me shënim me shkrim dore të personave të identifikuar me numër serie të kartave por pa nënshkrim të votuesit. U verifikuan kuponat e printimit të PEI-t për secilin votues, nga ku rezultoi se numri i tyre ishte më pak se numri i fletëve të votimit por edhe se numri i zgjedhësve. Në përfundim GNV mbajti procesverbal të kostatimit dhe propozoi për shqyrtim nga KQZ, hartoi tabelën e kontestuar në rubriken e tabelës sipas procesverbalit bashkëngjitur me dakordësinë e të katër anëtarëve të GNV-së.
5. Në **QV 3445 Bogdan** grupi i numërimit pas hapjes së kutisë së fletëve të votimit konstatoi se mungonte raporti i printimit të PEI-t përfshirë mungesën për raportin e hapjes dhe mbylljes, si dhe nuk kishte shënime apo konstatime në librin e protokollit. Gjithashtu, referuar edhe procesverbalit të mbylljes, u konstatuan 4 fletë votimi më tepër se numri i votuesve. Për këtë rast ka procesverbal të mbajtur nga GNV, me shënimin për KZAZ. Ndërkohë që edhe pse ky procesverbal mban shënimin për KZAZ, në përfundim të numerimit u hartua tabela e rezultateve. Pikërisht për këtë rast kemi dyshime të forta lidhur me çfarë ka ndodhur edhe pse ka një procesverbal për mospërputhje të firmosur nga të katër numeruesit. Në këtë qëndër votimi ka mungësë të theksuara që lidhen me mungesë të regjistrin të zgjedhësve ku konstatohet mos nënshkrimi i të gjithë zgjedhësve gjë e cila ngre dyshime mbi procedurën e votimit, mungojnë kuponat e votuesve nëpërmjet identifikimit elektronik, nuk ka asnjë shënim në regjistrin e vecantë të protokollit. Dyshimet e sipërcituara lidhen me procedurën e ndjekur nga KQV lidhur me mënyrën e verifikimit dhe nxjerrjes së rezultatit të pjesmarrjes në votim pranë kësaj qëndre nga momenti që nuk ka funksionuar PEI dhe në këtë qëndër nuk është nënshkruar në listën e zgjedhësve.
6. Në **QV 3318 Drobonik**, sipas vendimit të KZAZ është hapur kutia e votimit nga grupi i numërimit, është kostatuar mospërputhje e numrit të votuesve me fletët e votimit, kjo kuti është mbyllur (pa vendim apo procesverbal) dhe është lënë për në fund të numërimit, në mënyrë që të mos pengohet procesi. Është kërkuar suport nga KQZ suport i cili nuk i është dhënë. Pas disa orësh anëtarët e ZAZ kanë diskutuar mbi vendimmarrjen për administrimin e kësaj kutie. Nga libri i protokollit të mblëdhjeve pasqyrohet se tre anëtarë kanë kërkuar pavlefshmëri të kësaj kutie, ndërsa katër anëtarët e tjerë vendosën që kjo kuti të rinumërohet. Pasi ka përfunduar numërimi për subjektet politike, është risjellë me vendim të KZAZ kutia e lënë pa procesverbal të mbylljes apo konstatimit të parregullsisë së kostatuar nga grupi i parë i numërimit. Pas rihapjes së kutisë u kostatua se numri i votuesve nuk përputhej me fletët e votimit. U hap kutia e materialeve dhe nuk u gjend asnjë zgjedhës në regjistrin e posaçëm. GNV hartoi tabelën e rezultateve, dhe sipas konstatimit rezultoi se numri i zgjedhësve nuk përputhej. Në këtë moment nga KZAZ (Kryetaria dhe përfaqësuesit e subjektit PS) është kërkuar ndryshimi i shifrave faktike, por grupi i numërimit nuk ka pranuar, pasi nuk është kompetencë dhe e drejtë e tyre as ndryshimi i numrit të zgjedhësve por as fshehja e fletës së votimit. Pas disa orësh debatesh, konstatimi, kërcënimi e tensioni nga ana e KZAZ të ushtruar nga Kryetaria e saj, vërtetuar dhe nga kamerat 360 gradë, dhe procesverbal i mbajtur nga anataria e ZAZ-së Teuta Mucogllava, u ra dakord që tabela të hartohet saktësisht si u gjend në kuti por për shkak se sistemi nuk e pranonte për shkakun e mospërputhjeve u bë e mundur nëpërmjet manipulimit të shifrave ndërhyrja në sistemin qendror në KQZ, me qëllim për të mundësuar pranimin nga sistemi tabelën e rezultateve që nuk përputheshin. Si u saktësua më sipër, ngjarja është e dokumentuar nga sistemi i kamerave 360 grade në VNV dhe KAS mund ta hetoj administrativisht këtë element, qoftë dhe nëpërmjet intervistave me peronat përgjegjës apo dokumentacionit administrativ verifikues.



[Signature]
Nënshkrimi i Ankesës

7. Në QV 3356 gjatë numërimit të votave për kandidatët u konstatua se të gjitha votat ishin vendosur brenda zarfit 06 për subjektet politike dhe meqënëse sipas udhëzimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ky zarf nuk duhej të hapej, grupi i numërimit ju drejtua KZAZ-së për këtë problem të konstatuar. KZAZ sugjeroi plotësimin e tabelave me vlerën zero për çdo kandidat të çdo subjekti zgjedhor, praktikë kjo e ndjekur edhe për qendren 3324. Grupi i numërimit insistoi se nuk mund të vendoset një vlerë zero, pasi nuk ka zarf 08 dhe votat e kandidateve mund të jenë brenda zarfit 06. Pas kontaktimit të KQZ-së, nga ana e KZAZ u sugjerua që KZAZ të merrte vendim, nëpërmjet të cilit të urdhëronte numëruesit të shënonin vlerat zero për votat e kandidatëve (bashkëngjitur procesverbal i konstatimit nga numëruesit dhe vendimi i KZAZ për hartimin e tabelave). Më pas grupi i numërimit hartoi tabelat me vlerën zero duke i kontestuar në rubrikën e kontestimeve.
8. Gjatë numërimit të votave të kandidateve në zarfet 08 të subjektit PS u gjenden flete votimi të pavlefshme për kandidatin dhe subjektin në disa kuti. Ky fakt është konstatuar në shumë qendra votimi, eksplicitisht po citojmë QV-të vijuese: QV. 3265, 3267, 3281, 3285, 3305/1, 3305/2, 3316, 3311.

Nëpërmjet vendimit Nr. 17 datë 27.04.2021 për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve të ZAZ-së Nr. 66 Qarku Berat, në faqen 2 të tij konstatohet qartë votimi kundër i 3 anëtarëve të kësaj ZAZ-je përkatësisht zv/kryetari Renalda Jaho, anëtarët Fitim Rrapaj dhe Merlan Avale. Në mendimin e pakicës kontestimet e këtyre tre anëtarëve të ZAZ-së 66 pasqyrojnë parregullsitë e procesit duke saktësuar se:

- **Renalda Jaho:** është kundër këtij vendimi sepse në QV-në 3445 ka fletë votimi me shume se sa numri i zgjedhësve.
- **Mevlan Avale:** është kundër këtij vendimi sepse në QV-në 3445 ka fletë votimi me shume se sa numri i zgjedhësve. Grupi i numërimit ka mbajtur proces verbal për këtë fakt.
- **Fitim Rrapaj:** është kundër këtij vendimi sepse në QV-në 3318 dhe QV-në 3445 ka fletë votimi më shumë se sa numri i zgjedhësve. Nuk jam dakort me rezultatin e QV-së 3431, për shkak se ka shumë parregullsi të kontestuara nga GNV-ja. Grupi I numërimit ka mbajtur proces verbal për numërimin e fletëve të votimit që rezultojn më shumë se numri I zgjedhësve. Dhe I kanë firmosur të katër anëtarët e Grupit të Numërimit.

Lëvizja Socialiste për Integrim në përfundim të procesit të zgjedhjeve për Kuvendin e datës 25 prill 2021, menjëherë pasi ZAZ-të e Qarkut Berat proceduan me dërgimin e materialeve zgjedhore dhe pamjeve filmike të regjistrimit të procesit të numërimit pranë KQZ, pa vonesë ka marrë kopje të materialit video të regjistrimit të çdo vote në këtë Qark dhe ka proceduar me kqyrjen e cdo flete votimi të numëruar në VNV-të e këtij Qarku.

Në përfundim të procesit të kqyrjes së pamjeve video të cdo vote, ka rezultuar situata që pasqyrohet në tabelën e mëposhtme ku sqarojmë se:

Kolona 1 pasqyron ZAZ-në përkatëse, kolona 2 Tavolinën e numërimit, kolona 3 QV-në, kolona 4 rezultatin e votave për subjektin PS dalë nga kqyrja e pamjeve filmike, kolona 5 pasqyron votat e subjektit Ps sipas KQZ, kolona 6 pasqyron deformimin midis votave të kqyrura nga materiali filmik dhe votave të pasqyruara nga Tabele përmbledhëse e miratuara nga KQZ, kolona 7 votat e LSI rezultat i këqyrjes së pamjeve filmike, kolona 8 votat e Lsi sipas KQZ, kolona 9 diferencën ndërmjet votave të Lsi nga kqyrja e pamjeve filmike dhe votave sipas KQZ, kolona 10 pasqyron votat e pavlefshme nga kqyrja e pamjeve filmike, kolona 11 votat e pavlefshme sipas KQZ, kolona 12 diferencën midis votave të pavlefshme të kqyrjes së pamjeve filmike dhe votave sipas KQZ.



ZAZ	Tavolin e	QV	PS	PS KQ Z	Dif_P S	LS I	LSI KQ Z	Dif_LS I	P. V	P.V KQ Z	Dif_P V
63	1	333	11	122		3	10	10	0	4	4
	2		9						5	1	-
											4

[Signature]
Nënshkrimi i Ankesit

63	1	347 8	25 4	256	2	39	39	0	4	4	-
63	1	348 3	55	57	2	11	11	0	6	2	-4
63	1	3344 1	14 5	151	6	17	16	-	5	5	0
63	1	3485 1	15 3	154	1	10	8	-	2	2	-
63	2	333 3	15 4	152	-	15	14	-	8	5	3
63	2	334 7	19 5	198	2	3	63	63	2	5	-1
63	2	3468 1	17 5	174	-	13	11	-	6	5	3
63	3	334 5	18 8	189	1	21	21	0	2	3	6
63	3	348 1	95	95	0	27	23	-	7	3	6
63	3	348 6	16 6	167	1	12	12	0	1	1	-
63	1	348 7	17 1	169	-	20	19	-	4	2	1
63	3	348 9	16 8	169	2	1	21	21	0	3	6
63	3	3347 1	13 9	140	1	32	32	0	8	4	0
63	4	334 0	14 4	145	1	25	25	0	0	0	-
63	4	334 4	17 1	172	1	17	16	-	1	1	3
63		333 9	18 2	185	3	7	7	0	3	3	1
63		348 8	21 1	211	0	54	53	-	2	2	5
63		3343 1	84	86	2	6	5	-	4	4	6
64	1	350 4	11 0	109	-	8	7	-	5	9	0
64	1	349 3	16 7	167	1	1	1	1	2	2	-2
64	1	349 7	24 3	243	0	23	22	-	8	6	1
64	1	351 4	12 1	121	0	6	5	-	1	2	0
64	1	353 0	15 5	156	1	16	15	-	4	4	4
64	1	341 4	20 3	205	0	1	15	-	2	6	0
64	1	351 6	18 0	182	1	27	27	0	2	2	0
64	1	341 4	20 3	205	2	51	51	0	1	1	1
64	1	351 8	13 3	136	3	10	10	0	3	4	0
64	1	352 0	17 9	182	3	42	40	-	1	1	-
								2	9	9	0



[Signature]
 Nəşəçisi / Anketçi

64	1	352 4	14 4	147	3	9	9	0	1	1	-
64	2	342 6	14 9	146	- 3	25	24	- 1	3	1	2
64	2	3516 1	16 9	168	- 1	44	43	- 1	1	1	2
64	2	350 5	30 6	307	1	10 6	104	- 2	1 8	1 9	1

64	2	35111	128	129	1	23	23	0	13	12	-1
64	2	35141	89	90	1	24	24	0	19	17	-2
64	2	35241	136	137	1	10	10	0	10	10	0
64	2	3415	93	95	2	28	28	0	17	13	-4
64	3	3506	233	234	1	60	60	0	17	21	4
64	3	35311	137	138	1	15	13	-2	10	11	1
64	3	3416	215	217	2	20	20	0	23	19	-4
64	3	3492	207	210	3	37	36	-1	28	27	-1
64	4	35081	108	109	1	31	31	0	12	10	-2
64	4	3526	71	113	42	9	13	4	83	24	-59
64	4	3494	173	176	3	23	23	0	26	27	1
64	5	3513	200	201	1	39	38	-1	27	28	1
64	5	35192	76	77	1	10	10	0	10	9	-1
64	5	3522	156	158	2	39	38	-1	19	18	-1
64	5	3527	158	160	2	22	22	0	17	15	-2
64	5	35291	109	111	2	24	22	-2	9	9	0
64	5	35181	101	105	4	9	9	0	4	4	0
65	1	3271	98	99	1	11	11	0	2	3	1
65	1	3288	177	181	4	35	35	0	13	13	0
65	1	3309	104	104	0	25	23	-2	12	13	1
65	1	3311	218	219	1	25	24	-1	17	26	9
65	1	32971	162	162	0	35	34	-1	29	33	4
65	2	3297	189	191	2	26	26	0	27	26	-1
65	2	3313	177	179	2	29	28	-1	23	22	-1
65	2	3314	211	215	4	16	16	0	19	17	-2
65	2	3316	91	95	4	11	11	0	14	9	-5
65	2	32941	236	239	3	23	23	0	25	25	0
65	2	33041	97	102	5	15	15	0	13	7	-6
65	2	33131	126	128	2	12	12	0	17	16	-1
65	1	35132	157	160	3	14	14	0	16	13	-3
65	3	3295	143	143	0	27	26	-1	20	22	2
65	3	3303	92	98	6	9	9	0	9	5	-4
65	3	32841	127	128	1	15	15	0	20	19	-1

65	3	33052	150	154	4	27	27	0	19	18	-1
----	---	-------	-----	-----	---	----	----	---	----	----	----



[Handwritten signature]
 Ninoskrimi I Ankesti

65	3	33111	210	211	1	20	20	0	24	25	1
65	4	3267	130	131	1	13	13	0	9	9	0
65	4	3285	201	204	3	25	25	0	26	23	-3
65	4	3290	146	148	2	17	17	0	17	16	-1
65	4	3296	183	187	4	34	34	0	28	24	-4
65	4	3304	105	105	0	20	19	-1	9	11	2
65	4	3312	94	95	1	25	25	0	8	6	-2
65	4	32751	192	196	4	51	50	-1	17	15	-2
65	4	32801	91	94	3	5	5	0	16	12	-4
65	4	32911	123	124	1	15	15	0	12	11	-1
65	4	33051	216	220	4	22	22	0	24	19	-5
65	5	3287	147	149	2	22	21	-1	16	16	0
65	1	32871	83	85	2	15	15	0	23	19	-4
65	5	3294	213	214	1	27	26	-1	13	13	0
65	5	3300	138	139	1	30	30	0	19	19	0
66	3	3319	126	126	0	45	43	-2	12	10	-2
66	1	3322	184	186	2	52	51	-1	26	25	-1
66	4	3327	122	124	2	16	16	0	16	15	-1
66	3	3328	229	229	0	24	23	-1	25	94	69
66	2	3330	135	137	2	32	30	-2	21	32	11
66	4	3331	100	103	3	37	35	-2	19	21	2
66	4	3355	104	104	0	13	11	-2	29	33	4
66	1	3356	120	123	3	42	41	-1	15	13	-2
66	4	3360	174	176	2	30	29	-1	18	16	-2
66	2	3430	240	238	-2	33	31	-2	15	37	22
66	2	3438	130	134	4	17	17	0	19	18	-1
66	1	3439	108	109	1	28	28	0	25	25	0
66	4	3440	155	153	-2	18	16	-2	15	14	-1
66	1	3441	182	185	3	24	23	-1	24	22	-2
66	2	3442	205	205	0	27	26	-1	26	27	1
66	1	3450	114	115	1	4	4	0	12	12	0
66	2	3451	100	101	1	0	0	0	20	19	-1

66	1	34291	150	150	0	10	9	-1	18	20	2
66	2	34401	105	106	1	10	9	-1	12	11	-1
67	1	3458	205	207	2	17	17	0	18	16	-2
67	1	3461	241	240	-1	9	7	-2	23	25	2
67	3	3371	135	138	3	33	31	-2	7	6	-1
67	3	3457	180	181	1	10	10	0	7	8	1
67		3465	131	140	9	9	10	1	14	17	3
67	3	3576	127	128	1	34	34	0	13	13	0



[Handwritten Signature]
 Nana Krjini / Ankešić

67		3577	213	216	3	80	79	-1	16	14	-2
67	3	3578	155	161	6	62	61	-1	19	14	-5
67	1	35791	153	154	1	39	39	0	16	17	1
67	3	35801	161	167	6	61	61	0	20	14	-6
68	2	3536	64	65	1	53	48	-5	17	16	-1
68	2	3555	217	221	4	136	128	-8	36	29	-7
68	3	3556	198	200	2	185	183	-2	28	27	-1
68	2	3571	173	172	-1	94	93	-1	11	11	0
Total					233			-78			-12

Bazuar në të dhënat e mësipërme, në pjesën e kolonës horizontale të tabelës së kqyrjes së pamjeve filmike rezultojnë situata vijuese, subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë ka një numër prej 233 votash më tepër se rezultati i pasqyruar në tabelën përmbledhëse të Qarkut Berat. Subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim rezultojnë se nga totali i votave të pasqyruara në tabelën përmbledhëse të Qarkut Berat ka 80 vota më pak, pra vota të cilat nuk i janë logaritur këtij subjekti.

Nisur nga rezultati i shpallur nga KQZ, për ndarjen e mandateve në qarkun Berat, rezultojnë se Lëvizja Socialiste për Integrim, ka 77 vota më pak se sa herësi i 5-të i subjektit PS. Pra, nëse subjektin LSI, i shtohen 80 vota të hequra padrejtësisht, në total rezultati total i votave të këtij subjekti do të bëhet 8474.

Në rast se do të zbatohet formulën e ndarjes së mandateve sipas nenit 162 të Kodit Zgjedhor, për Subjektin Zgjedhor PS, rezultojnë se herësi i 5-të për këtë subjekt është 8471 vota. Pra siç shihet qartë, numri i votave të Subjektin LSI, është më i madh se herësi i 5-të i subjektit PS, rrjedhimisht PS duhet të përfitojë 4 mandate, PD 2 mandate dhe LSI 1 mandat.

FAKTET, ARGUMENTAT, DISPOZITAT LIGJORE KU MBËSHTETET ANKIMIMI.

Të gjitha faktet, indiciet dhe provat në disponimin tonë, provojnë në mënyrë të qartë dhe të pakundërshtueshme se kemi të bëjmë me shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor (madje në disa raste këto shkelje përbëjnë krim zgjedhor) dhe konkretisht:

- Nenet 115, 116, 116/1, 117 dhe 118 të Kodit Zgjedhor, si dhe nenit 42 të Vendimit nr.11, datë 25 Mars 2021 të Komisionit Rregullator (rasti i mospërdorimit të PEI-t dhe identifikimit manual pa vendim të KZAZ).
- Vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve Nr. 339, Datë 4.5.2021, "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatit e votimit në zonën zgjedhore Qarku Berat, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021", si dhe vendimet respektive të KZAZ-ve të këtij Qarku, janë akte të marra në kundërshtim me ligjin si dhe kanë cënuar drejtëpërdrejtë interesat e ligjshme të subjektit LSI, pasi një pjesë e mirë e votave janë lexuar në favor të subjekteve të tjera zgjedhore si dhe janë vlerësuar në mënyrë të gabuar, duke shtrëmbëruar kështu rezultatit real të votave që ka marrë subjekti LSI në këtë Qark.

Duke marrë shkas nga të dhënat e vëzhguesve dhe të numëruesve në GNV, LSI, kërkoi nga KQZ të pajisjej me regjistrimet e kamerave të procesit të numërimit për të gjitha ZAZ-të e kësaj zone zgjedhore. Materiali i cili na u vu në dispozicion nga KQZ-ja. Nga verifikimi i këtyre pamjeve filmike rezultojnë se numrit të votave të vlefshme, apo të përfshira si vota të vlefshme për një tjetër subjekt zgjedhor, është relativisht i lart. Nga leximi i këtyre anomalive apo parregullsive në kualifikimin jo të



[Signature]
Nënshkrimi i Komisionit

rregullt të votës, rezulton se subjektit LSI duhet t'i shtohen të paktën 80 (tetëdhjetë) vota sipas konstatimit të pamjeve filmike pasqyruar në QV-të e përmendura më lartë në tabelën shpjeguese. Pra natyra e shkeljeve të pretenduara në procesin e leximit dhe vlerësimit të votës, e bëjnë të detyrueshme këqyrjen e materialit zgjedhor me qëllim final rinumërimin dhe rivlerësimin për ato qendra votimi, ku nga leximi i materialit filmik, konstatohet qartë se vota e LSI është shpërdoruar qellimshëm dhe nuk është vlerësuar në mënyrë korrekte nga grupet e numërimit.

- Për të përforcuar këtë qëndrim të bazuar të LSI, në interesin më të lartë të procesit zgjedhor që ka të bëjë me numërimin e votave të këtij Qarku, janë administruar tabelat përmbledhëse dhe libri i protokollit të mbledhjeve të cdo KZAZ-je në qark, nga këto dokumente konstatohet se nga përmbajtja e vendimmarrjeve të cdo KZAZ-je rezultojnë parregullsi të shumta të cilat kanë cënuar procesin e votimit, të numërimit, të identifikimit korrekt të votës, nëpërmjet ndërhyrjeve që janë bërë me qëllim tjetërsimin e vullnetit të zgjedhësve të kësaj zone zgjedhore.
- Këto veprime vijnë në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe procedurat e caktuara në aktet e Komisionit Rregullator pranë KQZ dhe të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për sa i përket pasqyrimin real dhe të vërtetë të vullnetit të zgjedhësve. Kjo rrethanë përbën shkak ligjor sipas parashikimeve të nenin 160 dhe provon se vendimet e KZAZ-ve që të kundërshtojmë dhe gjithë procedura e mëpasshme që konkludoj me miratimin e tabelës përmbledhëse nga KQZ janë amrrë në kundërshtim të hapur me ligjin.
- LSI kërkon nga KAS që për nevoja të hetimit administrativ, ky organ kolegjal të vendosi të administrojë si prova Librin e Protokollit të Mbledhjeve, Proces-Verbalet e Konstatimit, të KZAZ objekt ankimi, tabelat e rezultatit të grupeve të numërimit për QV të e cituara na ankim, pamjet filmike të VNV-ve, si dhe cdo dokument tjetër të nevojshëm për një hetim administrativ të plotë dhe të paanëshëm.
- Kërkesa e LSI për rinumërim dhe rivlerësim, gjen mbështetje në nenin 138 të Kodit Zgjedhor, dhe në mënyrë të qartë bështetet në prova të cilat pasqyrojnë se gjatë procesit të numërimit dhe vlerësimit të votave sipas përcaktimeve të nenit 116, 119 të Kodit Zgjedhor ka patur shkelje të konstatuara për numërim jo të saktë të votave për çdo subjekt zgjedhor, dhe për më tepër nga aktet e VNV-KZAZ gjatë vlerësimit të votave ka patur kundërshtim nga ndonjë prej anëtarëve të grupeve të numërimit apo vëzhguesve të LSI apo subjekteve të tjera që kanë kontestuar parregullsi. Po sipas procedurave të përcaktuara në nenin 116, pika 6 dhe 118 të Kodit zgjedhor këto kontestime pasqyrohen në dokumentacionin zgjedhor si kundër është Procesverbali i Konstatimit dhe Libri i Protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së.
- Pavarësisht dokumentacionit të sipërpërmendur, materiali zgjedhor i nxjerr nga pamjet filmike në dshumë raste krijon dyshime të arsyeshme se vlerësimi i votës nuk është bërë në mënyrë të drejtë nga grupet e numërimit.
- Gjithashtu, LSI vlerëson se transparenca në lidhje me numërimin dhe vlerësimin e votave për zonën zgjedhore qarku Berat ka një rëndësi të madhe për besueshmërin e procesit zgjedhor dhe për integritetin e tij. Për sa koha LSI nga këqyrja e materialeve filmike ka konstatuar parregullsi, linden dyshime të arsyeshme se në disa qendra votimi objekt ankimi, vota nuk është vlerësuar saktë, dhe nevoja imediate që lind për transparencë të procesit të numërimit për këto Qendra Votimi, duhet domosdoshmërisht të bindi anëtarët e KAS të kërkojnë marrjen e provave për të vërtetuar faktet e paraqitura nga LSI nëpërmjet rinumërimit dhe rivlerësimit të votave në kutitë e votimit të qendrave të votimit sipas parashkrimeve të Kërkesës Ankimore. Në përputhje me parashikimet e nenit 136, pika 3 të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet shprehimisht se: "Kërkesa për marrjen e provave, sipas shkronjës "c" të pikës 1 të këtij neni, kur mbështetet nga dy anëtarë të KQZ-së dhe kur këto prova administrohen vetëm nga KQZ-ja, pranohet menjëherë pa iu nënshtruar debatit ose votimit në KQZ. Në këtë rast organi shqyrtues i Ankimit, pra KAS është i detyruar të procedojë menjëherë me marrjen dhe shqyrtimin e provave të kërkuara", dhe në përputhje me parashikimet e nenit 138 "Këqyrja e materialit



zgjedhor” të Kodit Zgjedhor, KAS me vendim të ndërmjetëm duhet të vendosi të kryejë rinumërimin dhe rivlerësimin e votave në QV-të sipas objektit të ankimit.

- Përsa i përket këtyre shkeljeve, të cilat i provojmë me pamjet filmike ku janë shkeluar në mënyrë flagrante nenet 116, 117, 118, 119 të Kodit Zgjedhor, KQZ bazuar në material provues të rivlerësoje votat në qendrat e votimit të kërkuara mësipër. Pasi te kryhet rinumërimi dhe rivlerësimi i këtyre kutive të votimit, KQZ të hartojë dhe të miratojë tabelën përmbledhëse përfundimtare duke shfuqizuar vendimin nr. 339 datë 04.05.2021.

Në vlerësimin tonë ka prova të mjaftueshme për të disponuar sipas objektit të kërimit.

Sa më sipër kërkojmë:

- Ndryshimi i Vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve Nr. 339, datë 4.05.2021 Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatit e votimit në zonën zgjedhore Qarku Berat, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021.
- Rinumërim dhe rivlerësim i votave për ZAZ-të 63, 64, 65, 66, 67, 68 dhe QV-të e listuara në tabelën e mëposhtme dhe miratim i tabelës përmbledhëse për zonën zgjedhore Qarku Berat duke përfshirë në të rezultatit e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave për QV-të e listuara në tabelë.

PROVAT QË PARAQITEN DHE /OSE KËRKOHEN, BURIMIN SI DHE NUMRI I TYRE.

1. Vendimi Nr.339 datë 4.5.2021 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
2. Librat e protokollit të mbledhjeve të ZAZ-ve objekt Ankimi
3. Proces verbal datë 26.04.2021 konstatimi i Numerueses se Tav. Nr.7 Teuta Mucogllava lidhur me Kutinë e Votimit Nr. 3318
4. Tabela përmbledhëse e Kandidatëve për Deputet ZAZ 66; QV Nr. 3324, GN. NR.7 nga ku saktësohet se shpërndarja e votave të vlefshme për kandidatët rezulton e plotësuar me 0 vota në të gjithë kandidatët.
5. Tabela përmbledhëse e Kandidatëve për Deputet ZAZ 66, QV Nr. 3356, GN. NR.1 nga ku saktësohet se shpërndarja e votave të vlefshme për kandidatët rezulton e plotësuar me 0 vota për të gjithë kandidatët.
6. Proces verbal datë 28.04.2021 lidhur me kutinë Nr. 3356 ku janë kostatuar vetëm zarfa 06 dhe pasqyrohet se grupi i numërimit nuk i ka hapur këto zarfa.
7. Proces Verbal datë 27.04.2021 mbi Qv-në 3445, ZAZ 66, ku janë dhendur shumë mospërputhje dhe 4 fletë votimi tepër në këtë kuti.
8. Vendimi Nr. 17 datë 27.04.2021 për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve të ZAZ-së Nr. 66 i kontestuar.



Tiranë, 9/5/2021

Me Autorizim
Përfaqësuesi Ligjor i Subjektit Lëvizja Socialiste Për Integrim LSI

Altin Kazian

